



ALUMNËT

pjesëmarrje direkte
në reformat e rëndësishme

ASP

Risia e ciklit të debateve të rrjetit alumni përgjatë vitit 2015, krijoi premisat e duhura për të përfshirë drejtëpërdrejtë alumnët e Shkollës në proceset e rëndësishme reformuese në vend. Reforma e Drejtësisë si dhe ajo e sistemit të Energjisë, ishin dy prej sektorëve ku alumnët u ftuan të ofrojnë ekspertizën e tyre. Përtej këtyre rekomandimeve profesionale, alumnët shërbyen gjithashtu edhe si promotorë të mëtejshëm të zbatimit të reformave të rëndësishme integruuese, të cilat kërkojnë mbi të gjitha informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për të patur suksesin e pritshëm.

Takime konsultuese mbi Drejtësinë

Komisioni i posaçëm parlamentar mbi reformën në Drejtësi e përfshiu rrjetin alumni në takimet konsultuese me grupet e ndryshme të interesit si rrjedhojë e debatit të zhvilluar më 12 Maj 2015, pranë kryesisë së Kuvendit. Në këtë takim me kreun e komisionit, Z. Fatmir Xhafaj, alumnët diskutuan mbi fenomenet negative që kanë prekur Drejtësinë dhe rekomandimet përkatëse se si mund të kapërcehen këto probleme. Diskutimet u protokolluan zyrtarisht nga komisioni parlamentar me synim për t'i bërë pjesë e materialit analitik të përgatitur në kuadër të takimeve me juristët dhe grupet e tjera të interesit. Një tjetër material i vlefshëm për komisionin, u cilësua dhe "Dokumenti Rekomandues mbi Eficiencën e Gjyqësorit", i përgatitur nga pjesëmarrësit e Shkollës të gjen-eratës 2014, në kuadër të iniciativave publike të Shkollës. Ky dokument, me 16 rekomandime përkatëse, iu dorëzua zyrtarisht Z. Xhafaj nga drejtori i Akademisë, Z. Erjon Tase. Në vijim të bashkëpunimit të nisur me komisionin e posaçëm parlamentar, alumnët u ftuan gjithashtu në muajin shtator për të ofruar rekomandimet e tyre mbi dy dokumenta të rëndësishme të aprovuara nga ky



Pjesëmarrje direkte në re

komision, më konkretisht dokumentin "Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë" dhe "Plani i Veprimit" për zhvillimin e kësaj strategjie. Komunikimi me komisionin vazhdon të jetë i hapur edhe pas përgatitjes së projekt- amendeve kushtetuese dhe diskutimit të gjerë publik për këto ndryshime.

Lobim për reformën e energjisë

Akademia e Studimeve Politike është e angazhuar prej pesë vitesh në krijimin e një Dialogu Publik gjithëpërfshirës mbi zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë. Falë mbështetjes nga GIZ, programi ka zhvilluar një sërë aktiviteteve sensibilizuese me anëtarët e parlamentit si dhe njësi të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Alumnët, pjesë e këtyre institucioneve qëndrore dhe vendore, por edhe aktivistë civilë

apo punonjës së medias, janë angazhuar në këtë dialog me komunitetet e zonave të Pogradecit, Korçës, Fierit dhe Durrësit, me qëllim krijimin e terrenit të duhur për zbatimin e duhur të legjislacionit të Energjisë. Nëpërmjet eksperiencës së krijuar, ASP nxitë gjatë vitit 2015 procesin e konsultimit publik me organizatat mjedisore si dhe bashkëpunimin përtej ndasive politike të deputetëve, anëtarë të komisioneve parlamentare, të cilët do të diskutojnë ligjin për Eficiencën e Energjisë. Finalizimi i këtij procesi lobimi dhe konsultimi, kulmoi me realizimin më 14 tetor 2015 të një seance dëgjimore në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. ASP dhe rrjeti i alumnëve bashkëpunoi me Parlamentin për të siguruar përfshirjen e të gjithë aktorëve në këtë proces të rëndësishëm, që ndihmoi në miratimin



Seanca dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese mbi projektligjin e efijencës së energjisë

Majtas, takimi me kryetarin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës në Drejtësi, z. Fatmir Xhafaj

Poshtë, Takimi i alumnëve me kryetarin e ri të bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj

ndryshme profesionale, sollën sugjerimet dhe idetë e tyre për të ardhmen e Tiranës. Z.Veliaj ftoi gjithashtu alumnët që të vazhdojnë kontributin e tyre në proceset publike dhe aktivizimin qytetar. ASP dhe Bashkia e Tiranës po kërkojnë të konsolidojnë bashkëpunimin e tyre me qëllim gjetjen e mundësive për krijimin e një dialogu të vazhdueshëm mbi çështjet e interesit publik.

Cikli i debateve do të vazhdojë të mundësohet nga ASP edhe në vitin 2016. Këto angazhime të alumnëve në proceset reformuese janë jo vetëm rezultat i vlerave individuale të anëtarëve, por edhe besueshmërisë dhe integritetit të dëshmuar ndër vite nga Akademia e Studimeve Politike. Institucione dhe organizma të ndryshëm kanë shprehur dëshirën që të bashkëpunojnë me rrjetin alumni në të ardhmen në inisiativa të ngjashme pozitive.

forma të rëndësishme

e ligjit pa ndryshuar dy nga pikat e debatuar: krijimin e Fondit Kombëtar të Efijencës së Energjisë si dhe Agjencisë së Efijencës së Energjisë.

Takim me kandidatët e bashkisë Tiranë

Zgjedhjet vendore dhe programet e kandidatëve të bashkisë Tiranë, si bashkia më e madhe në vend, ishin në fokus të debateve të alumnëve gjatë muajit qershor 2015. Gjatë javëve të fushatës elektorale, alumnët zhvilluan një diskutim të hapur me kandidatin e pavarur për bashkinë e Tiranës, z. Gjergj Bojaxhi. Debatu u fokusua tek vizioni dhe programi i një kandidati që është propozuar nga qytetarët dhe përbën një risi në mënyrën se si zhvillohen fushatat elektorale. Me të njëjtin fokus, rrjeti alumni pati një takim konsultues edhe

me kryetarin e ri të bashkisë së Tiranës, Z. Erion Veliaj. Debatu u përqendrua mbi vizionin, strategjinë dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të kryeqytetit. Alumnët, të cilët vijnë nga sektorë dhe karriera të



Në mbrojtje të vlerave të rrezikuara të Evropës

Forumi i Berlinit dhe seminari i Sarajevës hedhin bazat për krijimin e "Tryezave Qytetare"

Evropa po përballet së fundi me një sërë sfidash ekonomike dhe sigurie, të cilat rrezikojnë të kufizojnë liritë themelore dhe demokracinë. Terrorizmi islamik dhe kriza e emigrantëve po ndihmojnë rritjen e forcave ekstremiste brenda vetë Bashkimit Evropian, duke rrezikuar ngritjen e mureve të reja jo vetëm kufitare, por edhe "mureve" të paragjyqimeve dhe gjuhës së urrejtjes ndaj shoqërive të ndryshme. Në këtë situatë të krijuar, misioni i Shkollave të Studimeve Politike në krijimin e udhëheqësve dhe shoqërive demokratike, i këpërcen kufijtë kom-

bëtarë me synim ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe gjetjes së zgjidhjeve për të mbrojtur demokracinë në aspektin e gjerë ndërkombëtar. Alumnët e

rrjetit të 21 shkollave politike kanë nisur angazhimin e tyre për të gjetur përgjigjet e duhura ndaj këtyre rreziqeve.



Drejtorët e Shkollave në forumin e Berlinit. Në faqen tjetër, themeluesit e shkollës ruse dhe ministri i jashtëm gjerman Steinmeier; (poshtë) alumna Juliana Cici gjatë fjalës në seminarin e Sarajevës

Edukimi i votuesve të rinj në zgjedhjet vendore 2015

Akademia e Studimeve Politike ofroi kontributin e saj në edukimin e votuesve të rinj në zgjedhjet vendore të 21 Qershorit 2015. Programi i financuar nga Këshilli i Evropës në kuadër të ndihmës së tij për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në Shqipëri, u zhvillua në të gjitha shkollat e mesme të vendit me qëllim ndërgjegjësimin e rreth 35.000 maturantëve që votonin për herë të parë. Rrjeti alumni kontriboi për të siguruar bashkëpunimin

me institucionet përkatëse (MAS, KQZ dhe Drejtoritë Racionale të Arsimit), por edhe në organizimin e trajnimeve të mësuesve dhe shpërndarjen e bazës materiale në shkolla. Programi mori nota pozitive vlerësimi nga partnerët vendas dhe të huaj dhe është rekomanduar nga Këshilli i Evropës që të replikohet nga Shkollat Politike (Kosovë dhe Armeni) gjatë proceseve të ardhshme zgjedhore në vitin 2016. Programi konsistoi në përgatit-

jen e materialeve informative dhe edukuese si dhe trajnimin e 350 mësuesve, të cilët zhvilluan më pas tre orë mësimi për maturantët mbi rëndësinë e pjesëmarrjes dhe ushtrimit të të drejtës së votës. Fushata u finalizua me organizimin e një ushtrimi votimi në të gjitha maturat e vendit, me qëllim evidentimin e procesit real të votimit, por edhe evitimin e fenomeneve negative të delegimit të votës apo votimit familjar. Zbatimi i programit bazohet mbi eksperiencën e fituar nga Akademia në fushatat edukuese të zgjedhjeve vendore të vitit 2001 dhe ato të përgjithshme të vitit 2013 si dhe kapacitetet dhe ekspertizën e saj.



Forumi i Berlinit, angazhim për shkollën e Moskës

Shoqata e Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës, me iniciativën e shkollës së Moskës dhe së bashku me "Robert Bosch Stiftung", organizoi forumin me temë "Në kërkim të universalizmit të humbur" në Berlin, më 28 dhe 29 tetor 2015. Forumi u mbajt në selinë e "Robert Bosch Stiftung" me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të 21 shkollave anëtare, së bashku me të ftuar të tjerë të rëndësishëm nga Rusia, Franca, Gjermania, Norvegjia, Suedia dhe Britania e Madhe. Shkolla shqiptare u përfaqësua në këtë Forum nga drejtori i saj si dhe dy alumnët: Eralda Çani Met'hasani, këshilltare e Kryeministrit mbi të drejtën publike si dhe Ermal Gjinaj, kryeredaktor i "Bota.al" dhe editori i të përmuajshmes me analiza ndërkombëtare "Politika", përgatitur posaçërisht për rrjetin alumni.

Aktiviteti u përshëndet nga kryetarja e Shoqatës së Shkollave të Studimeve Politike, Catherine Lalumiere; ministri i jashtëm gjerman Frank-Egbert Steinmeier; themeluesi i shkollës së edukimit qytetar në Moskë, Yuri Senokosov si dhe studiuesi i njohur Ivan Krastev. Diskutimet e shumta gjatë dy ditëve të eventit theksuan nevojën e zbulimit të mënyrave të reja dhe ndërveprimit mes kulturave të ndryshme për të përballuar problematikat që rrezikojnë të kthejnë pas normat e bashkëjetesës paqësore dhe respektimin e të drejtave të drejtat e njeriut, lirinë, shtetin e së drejtës dhe demokracinë Ngjarjet e fundit në Ukrainë si dhe kriza e emigrantëve me të cilën përballlet Evropa, kërko-

jnë përgjigje të qarta dhe efikase nga shoqëritë tona. Pjesëmarrësit u ndalën edhe në situatën e vështirë në të cilën detyrohet të punojë së fundi shkolla politike e Moskës, si rrjedhojë e masave kontrolluese të vendosura nga qeveria ruse. Shoqata e Shkollave të Studimeve Politike, si organizmi që përfaqëson 21 shkolla politike, u zotua se do të ngrejë zërin për të mbrojtur aktivitetin e lirë të shkollës së Moskës, e cila është edhe shkolla e parë e krijuar në vitin 1992 nga Këshilli i Evropës.

Në Sarajevë për përgjigjen demokratike

Një tjetër aktivitet ndërkombëtar i shkollave politike ishte dhe seminari i zhvilluar në Sarajevë më 25-26 qershor 2015, me temë "Mbrojtja e demokracisë, lirisë dhe të drejtave të njeriut nga kërcënimet e brendshme dhe të jashtme". Ky aktivitet mbledhi së bashku mbi 40 alumnë nga 21 shkolla, që veprojnë nën ombrellën e Këshillit të Evropës në tre kontinente të ndryshme. Shkolla shqiptare u përfaqësua nga Juliana Cici, zv.komisionere pranë Avokatit të Popullit, e cila pati edhe rolin e folëses në një panel, si dhe Elvana Zhezha, drejtuese e "Qendrës Ballkanike për Zhvillim dhe Ndryshim". Qëllimi i këtij seminari ishte ofrimi i një



kontributi për të zgjidhur sfidat kryesore politike dhe shoqërore me të cilat përballlet sot Evropa dhe për të shqyrtuar rolin dhe përgjegjësinë e liderëve të rinj në zgjidhjen e tyre. Të nxitur nga përvoja e seminarit të vitit të kaluar (organizuar në Strasburg), organizatorët vendosën që tema të jetë në lidhje me temën e Forumit Botëror të Demokracisë, i cili u mbajt në nëntor në Strasburg, fokusi i të cilës do të jetë "liria kundrejt kontrollit - përgjigjja demokratike".

Seminaret, tashmë "Tryeza Qytetare"

Në vitin 2016 modeli i seminarit ndërkombëtar të alumnëve të Shkollave të Studimeve Politike do të zhvillohet më tej duke u kthyer në programin e "Tryezave Qytetare" të liderëve të rinj mbi gjendjen aktuale të qeverisjes evropiane dhe globale. Programi bazohet në bindjen se sfidat kombëtare, si dhe përgjigjet ndaj këtyre sfidave, kanë shkaqe dhe pasoja që i kapërcejnë kufijtë. Duke pasur parasysh këtë qasje pan-evropiane dhe dinamikën ndërkombëtare, këto takime do t'iu ofrojnë alumnëve dhe liderëve të tjerë të rinj të përzgjedhur një platformë për të studiuar trendet dhe sfidat, si dhe për të ndërtuar një rrjet kolegësh me qëllim gjetjen e mënyrave për të krijuar

një angazhim qytetar më të mirë në të gjithë Evropën dhe më gjerë. "Tryezat Qytetare" do të organizohen nga Shkolla Evropiane të Politikës në Stamboll në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës dhe Rrjetin e Shkollave të Studimeve Politike. Tryezat e para janë planifikuar në Berlin dhe në Strasburg në maj dhe qershor 2016.

Takimi i tretë vjetor i rrjetit Alumni

Në vijim të traditës së krijuar tashmë, Akademia e Studimeve Politike organizoi në dhjetor takimin e tretë vjetor të rrjetit alumni të Shkollës, në një ceremoni festive në hotel Tirana International. Pjesë e eventit ishte dhe ceremonia e diplomimit të 24 pjesëmarrësve të vitit akademik 2015, të cilët janë gjenerata e nëntë që diplomohet nga programi i Shkollës së Studimeve Politike. Që prej këtij momenti, këta të diplomuar u bënë pjesë e rrjetit të alumnëve të Shkollës, që tashmë numëron mbi 230 anëtarë. Ceremonia u përshëndet nga ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, Z. Christoph Graf dhe drejtuesi në detyrë i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Z. Olsi Dekovi, të cilët vlerësuan përgatitjen dhe



angazhimin e pjesëmarrësve dhe ftuan përsëri alumnët për të qënë të angazhuar në rrjetin e madh dhe të vlefshëm të Shkollës. Një raportim i aktiviteteve kryesore të vitit 2015 si dhe zhvillimet e pritshme të rrjetit alumni në vitin e ardhshëm u prezan-

tuan nga drejtori i Akademisë. Eventu u mbyll me një koktejl, ku alumnët dhe të diplomuarit patën mundësinë të takohen nën atmosferën festive të fundvitit. Lista e plotë e pjesëmarrësve të gjeneratës 2015 mund të gjendet në faqen 15.

Alumnët në Akademinë Rajonale për Demokraci

Programi i Akademisë Rajonale për Demokraci (RAD), “uli siparin” në fundin e vitit 2015 pas një eksperience pozitive tre vjeçare. Një nga eventet më të rëndësishëm rajonalë mbledhi së bashku mbi 150 udhëheqës të rinj nga shtate vendet e Ballkanit, falë bashkëpunimit të shkollave respektive të studimeve politike.

Në gjeneratën e vitit të tretë të RAD, nën temën “Ndërtimi i institucioneve demokratike”, u përzgjedhën për të marrë pjesë edhe dy alumnët: Endri Mykaj, këshilltar ligjor pranë zyrës së Kryeministrit si dhe Kjudjan Seferaj, drejtues i programeve të Mirëqeverisjes pranë



OSFA - Soros. Gjithashtu, alumnët Rezart Xhelo dhe Arbër Kadia iu bashkuan grupit si panelistë në seminarët e këtij viti. Ceremonia e diplomimit të gjeneratës së tretë u organizua së bashku me konferencën përmbyllëse të programit në Beograd nga 27-30 Nëntor 2015. Konferenca mbledhi

edhe njëherë së bashku pjesëmarrësit e gjeneratave të mëparshme. Folësve nga Shqipëria në këtë konferencë iu bashkua edhe alumni Sokol Bega, i cili aktualisht është monitorues pranë Misionit të Posacëm Monitorues të OSBE në Ukrainë. Programi i RAD u financua

nga Bashkimi Evropian dhe fondi “Balkan Trust for Democracy”. Rrjeti i shtatë shkollave politike të Këshillit të Evropës në rajonin e Ballkanit siguroi zbatimin e projektit në nivel vendor dhe koordinoi bashkëpunimin rajonal. Rrjeti i shkollave do të vazhdojë të kontribuojë për ndërtimin e një gjenerate të re udhëheqësish, të cilët do të kapërcejnë barrierat historike që ekzistojnë në Ballkan. Për më tepër detaje mbi programin dhe pjesëmarrësit, ju lutem të konsultoheni me faqen zyrtare online të programit: www.radwb.eu

Çfarë ka qënë për ju Shkolla e Studimeve Politike ?

Vlerësimet e disa prej alumnëve për programin e shkollës



IRMA KOPLIKU

Deputete e PD / Lektore pranë Universitetit të Shkodrës

"Kjo shkollë u bë një udhërrëfyes për atë që më pas do bëhej detyra ime e re, anëtare e Parlamentit. Trajnimet me personalitete shqiptarë dhe të huaj, pikëpamjet e tyre, shkëmbimi i eksperiencave me vetë studentët apo me lektorët, temat e shumta të diskutuara me profesionalizëm, të gjitha këto, më kanë dhënë një imazh më të plotë të politikës në tërësi. Një rrugëtim i jashtëzakonshëm, së bashku me shumë miq."



ELTJON HALIMI

Këshilltar i LSI pranë Këshilli Bashkiak Tiranë /
Prof. Asoc. Dr. pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore

"Përfitimi i njohurive në çdo shkollë është përherë një vlerë e shtuar në korpusin e ideve apo mendimeve të çdonjërit prej nesh, por realisht njohuritë e asimiluara në Shkollën Politike do të përbëjnë përherë një burim frymëzimi për një qasje europiane dhe civilizuese në çdo veprim apo aksion politik në dobi të përmirësimit të jetesës së komunitetit."



ALEKSANDRA BOGDANI

Gazetare pranë rrjetit investigativ BIRN

"Një pikëtakim i njerëzve të ndryshëm, por me qëllime të ngjashme, Shkolla është ngulitur në kujtesën time si një kohë e kaluar këndshëm, por edhe si një forum ku debatohej me seriozitet dhe pasion mbi çështjet e nxehta sociale dhe politike. Një rrjet që zgjat përtej muajve të zhvillimit të programit, e që vazhdon të na bashkojë edhe pas kaq vitesh nëpërmjet takimeve të alumnëve."



ALUMNI NË FOKUS



EVIS FICO

Eksperte në Drejtorinë e Shërbimeve të Punësimit dhe Migracionit- Shërbimi Kombëtar i Punësimit

“Një shkollë me një qasje të veçantë dijesh dhe mundësish për të njohur, shkëmbyer mendime me pedagogë e kolegë të zotë në shumë fusha të jetës. Shkolla në të cilën çdo pjesëtar skalit integritetin profesional dhe personal brenda një komuniteti intelektualësh, aty ku të punuarit në grup është një besim mes njëri-tjetrit dhe jo një grupim. Unë nuk jam lidere në politikë, por profesionalisht çdo ditë punoj në frymën që kjo shkollë më dha.”

KLODJAN SEFERAJ

Menaxher programi për integrimin evropian, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë/Soros

“Shkolla e Studimeve Politike është një mundësi interesante për të qënë pjesë e një formati ku përballen ide nga pjesëmarrës aktivë të fushës politike, ekonomike, sociale dhe mediatike, të cilët, përndryshe, rrallë mund të komunikojnë dhe bashkëpunojnë kaq pozitivisht me njëri-tjetrin në shoqërinë tonë.”



GENTIAN XHAXHIU

Shef i Programeve të Bashkëpunimit Territorial, Ministria e Integritimit Evropian

“Shkolla e Studimeve Politike ka detyrën sfiduese të përgatitjes së brezit të ri të liderëve, jo vetëm në fushën e politikës, por edhe atë të administratës publike dhe biznesit. Mendoj se ky është një rol unik, të cilin në arkitekturën edukative shqiptare e luan vetëm kjo Shkollë. Nëpërmjet resurseve dhe alumnëve të saj, kjo Shkollë ndikon vit pas viti në ndërgjegjjen publike të Shqipërisë.”



KLESTA HYSI

Lektore e së Drejtës Administrative pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

“Larg konceptit klasik të një shkolle, kjo është një hapësirë ku mësohet nëpërmjet diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave mes pjesëmarrësve. Nëpërmjet lektorëve të zgjedhur vendas dhe të huaj, debatet orientohen mbi çështje interesante të aktualitetit politik dhe politikave publike. Një mundësi e shkëlqyer për të njohur profesionistë të fushave të ndryshme dhe për të krijuar miqësi, që nuk përfundojnë me programin e shkollës.”



BLERINA DORACAJ

Këshilltare e PS në Këshillin Bashkiak Tiranë / Këshilltare pranë Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

“Si një aset i çmuar në 16 vite të angazhimit tim politik, Shkolla e Studimeve Politike ka forcuar tek unë dëshirën, bindjen dhe vullnetin e bashkëpunimit shumëpalësh. Ajo ka shtuar gjithashtu dëshirën për të rritur brenda dhe jashtë meje tolerancë, gjithëpërfshirje e angazhime për politikëbërjen në funksion të mirëqeverisjes së vendit.”

ADMIR MALAJ

Ekspert lokal për çështjet e mbrojtjes sociale

“Nëpërmjet Shkollës njoha persona shumë të veçantë, me të cilët zhvilluam kulturën e debatit dhe artin e të dëgjuarit. Së bashku ndërmorëm iniciativa publike dhe kuptuam rëndësinë e aktivizmit qytetar dhe politik në nxitjen e ndryshimit. Prandaj jam shumë i lumtur që isha pjesë e kësaj eksperience me kaq shumë vlerë, të cilën Shkolla e mban gjallë çdo vit me shumë përkushtim.”



ALUMNI NË FOKUS

IVA HYSENI

Juriste, Sektori i Studimeve dhe i Marrëdhënieve me Jashtë në Gjykatën e Lartë

"Shkollën Politike e shoh si një balancë midis politikanësh të rinj me një shpirt sa të lirë po aq frymëzues dhe modera-torësh vendas dhe të huaj me eksperiencë e me një kon-tribut të çmuar në këto njëzetegjashtë vite ndryshimesh politike. Për mua ishte një bibliotekë dijesh që duhet ruaj-tur me shumë kujdes dhe që duhet përkthyer në punë dhe kontribut për zhvillimin socio-politik të vendit. Një përvojë e vyer, teorike dhe praktike mbi labirintin e vështirë të quajtur Politikë."



FABIAN ZHILLA

Kërkues mbi krimin e organizuar
Lektor pranë Institutit Kanadez të Teknologjisë

"Vlera më e spikatur e kësaj Shkolle është dëshmia se standartet e politikës në Shqipëri mund të përmirëso-hen ndjeshëm. Kjo, nga individë të përzgjedhur profesionalisht, të cilët ndërtojnë dialogun politik dhe depolitizojnë dhënien e zgjidhjeve dinamike nëpërm-jet ekspertizës. Shkolla të ofron mundësinë e përf-shirjes në një mikrobashkësi njerëzish të suksesshëm, të cilët kanë potenciale për ndryshimin dhe ku zëri i çdo anëtarit të saj nuk humbet."



ERVIS MOÇKA

Zv.dekan i Universitetit të Vlorës
Këshilltar i PS pranë Këshillit Bashkiak Vlorë

"Kontakti me lektorët, ndër ekspertët më të mirë shqiptarë e të huaj, ndihmuan në krijimin e një këndvështrimi të ndryshëm dhe trajtim më të avan-cuar të fenomeneve socio-ekonomike. Puna në grup dhe ndarja e eksperiencave me pjesëmarrësit nga fusha dhe ide politike të ndryshme, ishin një experi-encë mjaft e rëndësishme. Fitova gjithashtu një rrjet miqsh, kolegësh dhe profesionistësh në sektorë të ndryshëm dhe nga gjithë vendi."





Foto familjare e takimit vjetor e rrjetit alumni. Dhjetor 2015

Rrjeti Alumni 2007-2015

VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratiane
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Specialist pranë stafit të Kryeministrit
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues

Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "Eorld Vision"
Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet
Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës holandeze në Tiranë
Znj. Elma Teršana (Shehu)	Drejtoresh e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të fëmijëve (UNICEF)

Z. Elton Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës
Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP
Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtoresha e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjykatën e Lartë
Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM

RRJETI ALUMNI 2007-2015

Z.	Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z.	Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj.	Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD
Znj.	Sidita Gipali	Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë
Z.	Teki Kurti	Kryetari i Këshillit të Komunës Martanesh

VITI 2008

Znj.	Arbana Dibra	Drejtoresh e zyrës së OSBE-së në Shkodër
Z.	Arben Vata	Kryeredaktor, "Ora Neës" TV
Znj.	Beslinda Rrugja	Asistent avokate
Z.	Bledar Kurti	Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Znj.	Brasena Koka	Koordinator projekti pranë organizatës "Eorl Vision"
Znj.	Brunilda Minaroli (Peci)	Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme
Znj.	Edlira Gjoni	Koordinator projektit EU-CARDS VET tënning / Gazetare
Znj.	Edlira Mali	Drejtoresh e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë
Znj.	Edlira Papavangjeli	Koordinator Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit
Znj.	Elda Zotaj	Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës
Z.	Elson Thana	Oficer i Policisë Gjyqësore
Znj.	Elvana Zhezha	Shef i Kabinetit të Ministrisë e Punëve të Jashtme
Znj.	Eralda Cani Methasani	Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Z.	Erion Avllazagai	Lektor në Universitetin e Elbasanit
Z.	Erjon Tase	Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"

Z.	Erlis Cela	Gazetar në gazetën "Standard"
Z.	ERVIN KARA-MUCO	Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"
Znj.	EVIS FICO	Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit
Z.	FLIR MOSHO	Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave
Znj.	GENTIANA RAMADANI	Drejtoresh e ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"
Z.	GJERGJI TANE	Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë
Z.	GJOK VUKSANI	Deputet
Znj.	IVIS NOCKA	Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes
Z.	KLODIAN RJEPAJ	Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik
Znj.	KLODIANA GJINAJ	Këshilltare për mediat pranë KESH
Z.	MARIN MEMA	Gazetar "Top Channel"
Znj.	MONIKA STAFI	Gazetare "Top Channel"
Znj.	NAHLE BEJLERI – FICO	Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror
Z.	OLSI KARAPICI	Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave
Z.	REMZI ALIAJ	Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror
Z.	REZART LAHI	Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"
Znj.	SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI	Menaxhere e "Opportunity Albania"
Znj.	VILMA PREMTI	Drejtoresh në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z.	Adrian SHEGA	Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë
Znj.	Admira Poci	Specialiste pranë Institutit Goethe
Znj.	Albana HANA	Specialiste në Ministrinë e Integritimit

Znj.	Ana XHEKA	Drejtoresh në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Znj.	Ardita SHEHAJ	Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës
Znj.	Beti NJUMA	Gazetare, "Top Channel"
Z.	Blerim KOLA	Kryeredaktor, Nesër TV
Z.	Edvin SHVARC	Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokollit pranë Presidentit të Republikës
Znj.	Elira CANGA	Gazetare, "Gazeta Shqiptare"
Znj.	Elsa TOSKA (DOBJANI)	Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese
Znj.	Entela HAMITI	Anëtare e Partisë Socialiste
Znj.	Erinda SHAH	Anëtare e Partisë G99
Z.	Ermal GJINAJ	Kreu i departamentit të marrëdhënies publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë
Z.	Eugen Pepa	Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Genc HOXHA	Supervizor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania
Z.	Gentian ISLAMI	Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia e Kuçovës
Z.	Gentian MANO	Menaxher i organizatës "Eorl Vision", Librazhd
Znj.	Gerta META	Drejtoresh e Ekzekutive e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)
Z.	Hysni AHMETAJ	Specialist në Ministrinë e Integritimit
Z.	Illir TOPI	Aktivisti i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Ingrit PRIZRENI	Shtëpia Botuese "Media Print"
Znj.	Liliana ALIMETA	Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave
Znj.	Mimoza KOCIU	Këshilltare për median, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës
Z.	Plarent RUKA	Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Znj.	Plejada GUGASHI	Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania

Z.	Redi BADUNI	Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane
Z.	Redi SKENDERAJ	Gazetar, Koha TV
Znj.	Rezarta GODO	Programi "Brain Gain", PNUD
Znj.	Sonila MECO	Gazetare, Klan TV
Z.	Urim BAJRAMI	Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z.	Afrim Kola	Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare
Z.	Alban Fishka	Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror
Znj.	Aleksandra Bogdani	Kryeredaktore në "Top Neës" TV
Znj.	Anila Shqypi	Koordinatore projekti, GTZ Albania
Z.	Arber Kadia	Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë
Z.	Besjan Pasha	Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI
Z.	Bilbil Keraj	Shef i kabinetit në Bashkinë Kukës
Znj.	Blerta Gjermani	Kryeredaktore , ORA Neës TV
Z.	Dritan Nushi	Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë
Znj.	Eglantina Bisha	Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"
Z.	Elton Lula	Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë
Znj.	Enina Mullaj	Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Enkes Shundi	Këshilltar, Shef i Protokollit të Presidentit të Republikës
Z.	Evarist Beqiri	Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror
Znj.	Fatjona Mejdini	Gazetare, "Shqip"

Z.	Fjorel Como	Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës
Z.	Genard Kastrati	Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve
Znj.	Giomela Gjini	Drejtor Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z.	Ilir Paco	Gazetar "Top Channel"
Znj.	Irena Kita (Dimushi)	Specialiste ligjore në Bankën Credins
Znj.	Jonida Shehu	Gazetare në "Vizion Plus" TV
Znj.	Karolina Risto	Kryeredaktore e Vizion Plus TV
Znj.	Klodiana Thartori	Koordinatore Programi "Save the Children"
Z.	Klodjan Seferaj	Këshilltar në Këshillin e Ministrave
Znj.	Klotilda Neziri	Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit
Z.	Ledio Milkani	Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë
Znj.	Migëna Muhaj	Koordinatore në programin Seiss Partnerships in Health
Znj.	Migëna Nelaj	Drejtoreshë për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH
Z.	Ols Lafi	Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Znj.	Oriana Arapi	Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimin në Këshillin e Ministrave
Z.	Qemal Cejku	Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës
Znj.	Rozana Celmeta	Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z.	Saimir Shatku	Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës
Znj.	Suela Cela	Specialiste në departamentin ligjor në Ministrinë e Bujqësisë

VITI 2011

Znj.	Ada Ramaj	Ndihmëse e zv.ministrit të Brendshëm
Znj.	Albana Veizi	Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës
Z.	Alvi Bajramaj	Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT
Znj.	Anxhela Andoni	Aktiviste e Forumit të Gruas të Partinë Socialiste, rrethi Pogradec
Z.	Arlind Lugji	Specialist në Zyrrën e Regjistrimit të Pasurive
Z.	Arnold Hajro	Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)
Znj.	Daniela Mehmeti	Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës
Znj.	Enila Hasani	Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme
Z.	Enio Haxhimihali	Shef kabineti në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit
Znj.	Erjola Muka	Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë
Z.	Genti Çani	Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Z.	Gentian Xhaxhiu	Gazetar "Shijak TV"
Znj.	Gresa MARTIRI	Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë
Z.	Helidon BELE	Drejtor në Tirana Bank
Z.	Ilir Stojku	Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë
Znj.	Klesta Hysi	Koordinatore programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"
Z.	Kreshnik Ternova	Administrator, ALK Pharma sh.p.k.
Znj.	Ledi Jahja-Muçaj	Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri
Znj.	Merita Mansaku-Meksi	Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim

RRJETI ALUMNI 2007-2015

Znj.	Mirjam Reçi	Drejtoreshë ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës
Znj.	Olta Blaceri	Kryeredaktore e programit "Ora e debatit" në "Ora Neës" TV
Z.	Qamil Dika	Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist i PD
Znj.	Rajmonda Lajthia	Gazetare, "Vizion Plus" TV

VITI 2012

Znj.	Albana Shtylla	Shëfite kabineti në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të zgjedhjeve
Znj.	Alisa Demollari	Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë
Z.	Altin Hoti	Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian
Z.	Altin Ibro	Jurist/ Celibashi Consulting shpk
Z.	Andi Seferi	Drejtues i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri
Znj.	Anisa Seferaj	Juriste/ Bashkia Tiranë
Znj.	Ardita Kongjonaj	Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit
Z.	Arian Galdini	Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi
Znj.	Baisa Sefa	Kërkuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri
Z.	Elidon Laze	Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Erlis Shahu	Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Z.	Ermal Simaku	Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste
Z.	Ermir Godaj	Shërbimi i Përbërimit, Ministria e Drejtësisë

Znj.	Ervina Domi	Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave
Znj.	Eva Dauti	Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive
Znj.	Florensa Haxhi	Koordinatorë e strategjive në Këshillin e Ministrave
Z.	Fredi Guga	Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/ Koordinator projekti në "Europartners Development"

Z.	Ilir Kondi	Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)
Z.	Ilir Korbi	Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Ilir Mimani	Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Znj.	Jorina Gjinari	Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future
Z.	Ledio Braho	Jurist në Ministrinë e Integritetit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës
Znj.	Margarita Kola	Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktiviste e partisë politike Aleanca Kuqezi (AK)
Znj.	Mariola Qesaraku	Koordinatorë projekti pranë Institutit për Demokraci dhe Meditim
Znj.	Marsida Çela	Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/ Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA
Znj.	Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj.	Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënieve me Publikun në Postën Shqiptare
Z.	Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Z.	Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE
Znj.	Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj.	Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z.	Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj.	Suela Lala	Aktiviste në Shoqërinë Civile

VITI 2013

Znj.	Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
Znj.	Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktiviste në Partinë Demokratike (PD)
Z.	Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
Z.	Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
Z.	Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënësi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
Znj.	Blerina Doracaj	Eksperte ligjore dhe prokurimesh në Agjensinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktiviste në Partinë Socialiste (PS)
Znj.	Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktiviste e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj.	Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect
Znj.	Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktiviste në partinë politike Aleanca Kuqezi (AK)
Znj.	Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktiviste e Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet
Z.	Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
Znj.	Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integritetit/ Aktiviste në Partinë Socialiste

Z.	Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
Znj.	Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
Z.	Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
Z.	Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Z.	Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës
Znj.	Klementina Cenckollari	Gazetare, "Ora Neës" TV
Z.	Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave
Znj.	Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
Znj.	Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktiviste e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
Znj.	Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BCC Tirana

VITI 2014

Znj.	Alma Binaj	Asistente pranë zyrës të deputetit Edi Rama në Vlorë
Znj.	Anisa Xhafa	Specialiste e marrëdhënieve publike pranë GIZ Albania/ Aktiviste e partisë FRD
Znj.	Arsela Gjonaj	Specialiste pranë Këshillit Bashkiak Tiranë / Lektore në universitetin e Beratit
Z.	Dritan Cekani	Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave / Aktivist i Partisë Socialiste
Z.	Elidon Lamani	Menaxher projektesh pranë organizatës "Qendra Rinore e Vlorës"/ Aktivist i shoqërisë civile
Z.	Endri Mykaj	Këshilltar ligjor pranë Këshillit të Ministrave
Znj.	Enisa Halili	Specialiste pranë drejtorisë së Planifikimit strategjik të Bashkisë Tiranë

Z.	Erlis Hereni	Këshilltar ligjor pranë ministrit të Brendshëm / Drejtor ekzekutiv i "Aleancës së Rinisë Shqiptare"
Z.	Florjan Mucaj	Nënkryetar i Bashkisë Fier/ Aktivist i Partisë Socialiste
Z.	Francesko Mucaj	Sekretar politik i forumit rinor të Partisë Socialiste
Znj.	Ina Metko	Juriste, Ministria e Integritetit Evropian
Z.	Juel Jarani	Zv.rektor në Universitetin e Sporteve
Znj.	Juliana Cici	Zv.komisionere pranë "Avokatit të Popullit"
Z.	Lulzim Omuri	Këshilltar i minibashkisë nr. 2, Tiranë / Aktivist i forumit rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Magi Apostoli	Koordinatorë projekti pranë "Europartners Development"
Znj.	Pranvera Myrselaj	Menaxhere financiare pranë "System Group Albania"
Z.	Redi Saliasi	Përgjegjes i PR dhe komunikimit pranë kompanisë "Croën Agents"
Znj.	Rikelda Balliu	Koordinatorë e projektit të Bashkimit Evropian pranë drejtorisë së doganave
Znj.	Vjollca Dako	Drejtoreshë ekzekutive e fondacionit mediatik "Dritan Hoxha"

VITI 2015

Z.	Admir Malaj	Këshilltar pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
Znj.	Amela Juka	P.administratë / Political activist DP
Znj.	Arlinda Hoti	Drejtoreshë trajnimeve, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
Z.	Artur Bardhi	Specialist pranë Dep. Të Integritetit, Ministria e Punëve të Jashtme / Aktivist i LSI
Znj.	Blerina Ago	Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë

Znj.	Dorina Puto	Eksperte ligjore pranë Institucionit të Presidentit të Republikës
Z.	Elvin Nuriu	Drejtor i administratës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore / Aktivist i PDIU
Znj.	Erjona Rusi	Gazetare, Report TV
	Erton Graceni	Këshilltar për Teknologjinë pranë Këshillit të Ministrave
Z.	Ervis Mocka	Zv.dekan i Universitetit të Vlorës / Këshilltar i PS pranë Këshillit Bashkiak Vlorë
Znj.	Evis Shurdha	Drejtoreshë e Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
Z.	Fabian Zhilla	Kërkues mbi krimin e organizuar / Lektor pranë Institutit Kanadez të Teknologjisë
Znj.	Gentiola Madhi	Kërkuese pranë organizatës Shtetëbë
Znj.	Irma Kopliku	Anëtare e Parlamentit / Lektore pranë Universitetit të Shkodrës
Znj.	Jerina Vataj	Këshilltare e LSI pranë Këshillit Bashkiak Lezhë
Znj.	Jolanda Mustafaraj	Këshilltare e PS pranë Këshillit Bashkiak Durrës
Znj.	Lindita Pali	Këshilltare pranë Këshillit Bashkiak Burrel
Znj.	Marsida Duli	Doktoreshë / Aktiviste e PD
Znj.	Mirjeta Gjonec	Këshilltare e PD pranë Këshillit Bashkiak Bajram Curri
Z.	Oljan Kanushi	Koordinator pranë Këshillit të Ministrave
Z.	Sofjan Jaupaj	Këshilltar i Ministrit të Kulturës
Znj.	Tresi Trebicka	Menaxhere programesh mbi zhvillimin e qëndrueshëm pranë "Eco Partners Albania"
Znj.	Valbona Mucaj	Trajnuese pranë Shkollës Shqiptare e Administratës Publike
Znj.	Zhanina Dapi	Drejtoreshë e drejtorisë së Integritetit, Ministria e Ekonomisë

* I referohet pozicionit të mbajtur gjatë periudhës së pjesëmarrjes në program

ASP AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE PUBLIKIME



Vlerësimi i situatës së përdorimit të energjisë në Pogradec dhe Korçë

Botimi synon të analizojë situatën e përdorimit të energjisë dhe mundësitë për hartimin e një Platforme Vendore Veprimi në rajonin e Pogradecit dhe Korçës. Rekomandimet përkatëse janë rezultat i vlerësimit të nevojave nëpërmjet pyetësorëve si dhe konsultimit me aktorët vendor.



Platforma ndërkufitare e veprimit mbi zhvillimin e energjisë Shqipëri-Maqedoni

Platforma Rajonale për Veprim mbi përdorimin eficient të energjisë në Pogradec, Korçë - Shqipëri dhe Manastir, Kërçovë - Maqedoni, synon rritjen e informacionit dhe hapave konkretë që do të mund të ndërmarrin bashkitë pjesëmarrëse në vijim të një procesi të gjerë konsultues.



Manuali për zgjedhësit e rinj (2015)

Ky manual është përgatitur për të informuar të rinjtë dhe këdo tjetër mbi sistemin zgjedhor, të drejtat dhe detyrimet e votuesit, por gjithashtu mund të shërbejë si një burim i mëtejshëm i edukimit qytetar mbi demokracinë, sistemet politike, organizimin e shtetit dhe funksionimin e institucioneve të vendit.



Manual mbi angazhimin në politikat publike për Eficiencën e Energjisë

Manuali përpiqet të sjellë një përmbledhje të ideve, rekomandimeve dhe eksperiencave të OJF-ve nga Evropa Juglindore, të fokusuara mbi politikat publike të Eficiencës së Energjisë. Botimi u përgatit nga ASP në kuadër të aktiviteteve të projekteve rajonale STRONG SEE dhe PDI.



Buletini i shkollave politike të Këshillit të Evropës

Buletini i veprimtarive të Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës është një botim periodik tremujor në gjuhën angleze rreth aktivitetit të shkollave. Për të siguruar numrat e buletinëve, mund të abonoheni falas online në faqen e shoqatës së shkollave politike.



Buletini i analizave ndërkombëtare "Politika"

Ky botim i Akademisë së Studimeve Politike dhe "Bota.al", sjell në gjuhën shqipe një përzgjedhje të artikujve dhe analizave elitare të mendimit botëror. Çdo muaj trajtohet një çështje në optikën vizionare të liderëve politikëbërës dhe mendimtarëve më të njohur të momentit.

Akademia e Studimeve Politike

Kotoni Center, Tel/fax: +355 4 2272173
Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, +355 4 4504788
Kati 4, Zyra 2 E-mail: info@asp.al
Tirane, Shqipëri Web: www.asp.al

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha botimet në versionin pdf.
Skanoni këtë kod për më tej QR CODE



Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
 Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
 Akademia Studimeve Politike
 Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Ambasada e Zvicrës në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri